

BIBLIOTEKA
SHTETIT

854-1
M 41

**VOJSAVA
NELO**

E qeshur

poezi

SH-1
241

Vojsava
Nelo



13866

E QESHUR

poezi

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Pranverën derdhmani në gjoks

Ju sjell ndër mend, nxënësit e mi,
ju nxënësit e fshatit malor,
ju sjell ndër mend me mall e dashuri,
shpeshherë, o fëmijë ju kujtoj.

Si tufëz me lule në këngën time,
do mbeteni çelur përjetësisht,
çdo pranverë do të përtërihet
prej mallit e prej dashurisë.

Ju sjell ndër mend, o nxënësit e mi,
oborrin mbushur plot dhe përplot.
Mbushmani zemrën time, o fëmijë!...
Derdhmani pranverën në gjoks!...

Pranvera e syve

U zbardh qyteti krejt.
Çorovoda jonë nuse,
një vogëlushe vjen në bibliotekë
me fluturza bore mbi supe.

Kërkon një libër, kërkon një yllkë
sytë i ndriqnë si diell,
Peizazhi dimëror shtrihet jashtë,
brenda,
pranvera e syve.

Kemi Partinë

Më parë erdhi te ne Partia
se sa nëna te bija.
U tundën malet, toka,
shqipet qenkan më të forta!

Më të fortë se tërmeti,
më të fortë se stuhia,
kur Partia shkon mes njerëzve,
më shpejt se nëna te bija.

Si vajzë e dashuruar

Kam ardhur shpesh te ty Rivierë,
dhe prapë do të vijë, si vala në breg vjen.

Në çdo ardhje më fal ti motive,
dhe çaste mbushur me blerime.

Mbushur me aromën e portokallit,
që të deh tek ecën krah djalit.

Si dega e bëshme që nesër lëshon frytet,
prej tyre e shëndetshme kënga do të rritet.

Këngë e lirë në brigjet e kaltra,
ku vjen e bëhet copë e thërrime dallga,

ku lindin mëngjeset nën degëzat e blerta
ngadalë si të rrinin të fshehta.

Një mbrëmje, Rivierë, me ty bashkë,
kaq pak fjalë futur në varg.

Nuk munda, nuk munda të shkruaja më gjatë,
si vajza e dashuruar që djalit i thotë pak.

Mes nesh komisar

Nga malet tona morëm një gur
skalitëm portretin tënd,
komisar!
Fytyrë e gjallë,
buza gjysmë e hapur nga fjalë e pathënë,
sytë zjarr.

Mbi gur i heshtur, i skalitur
shoku komisar,
ish kohë betejash, kohë lufte,
dhe yjesh përmbi ballë.

Mbi gur i heshtur i skalitur...

Ne vrasim mendjen dita - ditës
për grurin që piqet në arë,
për shqetësimet që vërtiten globit,
për barkun e zezakut nga bajoneta çarë,

ne vrasim mendjen,
komisar!

Ty s'të rrihet,
heshtjen brenda gurit brën
zemra jote — zjarr.

Mes nesh epik ë madhështor,
shoku

komisar!

Agu i mëngjesit e gjeti zgjuar

Nuk e zinte gjumi atë natë,
qe bërë dasma e birit të saj.
Ajo dhe yjet qenë zgjuar akoma,
të tjerët të gjithë të flenë ranë.

Zbardhi dita e në jatakun e qiellit
edhe yjet ranë në qetësi,
vetëm ajo nuk u mbështet fare,
vetëm ajo nuk mbylli sy.

Të gjitha i vuri në vend me merak
enët, këpucët në prag të shtëpisë,
pastaj u nis për ujë në krua,
në maj të gishtave u nis.

U ul mbi gur sa të mbushej gjymi,
u ul mbi gur e sytë iu mbyllën,
mëngjesi ra mbi supe malesh,
mbi pagjumësinë e nënës.

Skrapari i ri

I bukur Skrapari i ri,
i bukur, e thotë çdo njeri.

Ngrihet mes grykash i fortë,
si trim i rrallë në shqotë.

Skrapari i rilindur i bukur
buzëbrëmjeve mes dritash përskuqur...

E qeshur

Gjithmonë në fytyrën tënde buza e qeshur,
tjetër trajtë s'ka.
Ashtu përgjysmë e hapur,
si hëna.

Gjithmonë në fytyrën tënde buza e qeshur,
trajtë tjetër s'ka,
Rini!

Mësuesja e dy fshatrave

Përkulen ekualiptet thellë
në dy krahët nga era,
era që fryn midis tyre
i përkëdhel asaj kaçurrelat.

Ecën kështu vazhdimisht
në udhën që midis tyre zgjatet,
rrethuar nga majat si kurorë,
përkulur në formë harqesh.

Në dy fshatrat që lidh kjo udhë,
mbushur me diellin e mëngjeseve,
kalimtarët i dhurojnë asaj
tufën e bukur të buzëqeshjeve.

Ajo ecën urtësisht,
në udhën mbuluar me harqe ekualiptesh
një këngë e lehtë në gojë...
Dhe era që lot me kaçurrelat.

Pëllumbat e gëzimit

Sot hyra në shtëpinë e re,
që ma ndërtuan duart tuaja,
gëzimi im ngjitet, puth re
hapësirave të kaltëruara.

Sot hyra në shtëpinë e re,
sa rreh zemra në hapjen e parë,
dhe hyj e dal nëpër ballkon
dhe rri mbështetur mbi dritare.

Këtu do të vendos saksii,
atje gjithë librat radhë-radhë,
nëpër dritare e rreze drite,
do varet lehtas tyli i bardhë.

Përballë do vë televizorin,
shtëpia të më gjëmojë këngë,
të nesërmen njerëzit do më thonë,
shumë vonë e fike dritën mbrëmë

Qesh fytyra plot me diell
djalin marr në krahë gjithë gaz,
pëllumbat e gëzimit ikin,
fluturojnë e ngjiten lart.

... Ju që ndërtoat shtëpinë
në qetësi tani lodhjen largoni,
e ndoshta tani në ëndër
një pallat të ri ndërtoni.

Hyjnë atje çifte të rinj
ju i shihni buzëgaz
dhe e ndieni lumturinë
gjer në zemër, gjer në gjak.



13866

Letra e ushtarit

Nga larg erdhi letra,
letra e ushtarit,
mbushur plot me mall,
me mallin e djalit.

E shfletonte nëna
lehtë e me ngadalë,
zogjtë përmbi pemë
këngës ia dhanë.

Këndoni, zogj, këndoni
bashk' me zemrën time
më ka shkruar djali,
iu bëfsha të syve!

Shihni ç'kam në duar,
kam letrën e djalit,
kuptojani zemrën
nënës së ushtarit.

Pastaj e mbështjell,
lehtë e me ngadalë,
e vendos në zemër,
ndënë xhamadan.

Ku pikoi qumështi,
mbi buzë i bardhë,
rri letra e djalit
në gjoksin e madh.

Rri e mendoj

Rri e mendoj mbi kokën tënde, bir,
rri e mendoj me orë të tëra,
të përkëdhel si një trëndafil,
që ka hapur petalet nga pranvera.

Si ti kam qenë dhe unë njëherë
rri e mendoj mbi kokën tënde, bir,
ndërsa nusëri e bukur tretet
tek ty për t'u përtërirë.

Si ti kam qenë dhe unë njëherë,
mbi krye natyrisht më rrinte nëna.
A ia kam shpërblyer vallë mendoj,
a ia kam shpërblyer dot të tëra?

Mundimet e saj me ohe të zgjatura,
për shëndetin tim shkuar keq,
më therin në zemër pas kaq vjetësh,
o, nëna me gjith mend qenka e shtrenjtë!

Dhe i fal një mijë buzëqeshje

Çdo mbrëmje marr djalin në qerdhe,
në krahët e mi buron lunturi.

Çdo mbrëmje ajo bri meje,
merr fëmijët e saj jo një, po dy.

Dy binjakë të vegjël të shëndetshëm
asaj nëne sa ia mbushin jetën.

Unë rri e mendoj atë në heshtje
dhe i fal një mijë buzëqeshje.

Ajo vazhdon rrugën mbi asfalt
unë rri e vështroj shumë gjatë.

Pëllumbat që i çuqurisin asaj në vesh
i derdhin në zemër jetë.

Ky çast

Pas çdo «mburoje» ai zgjat kokën
e me zërin e hollë ma bën taaa...
Lumturia që më fal ky çast,
shndrit në sytë e mi.

Pas çdo «mburoje» ai zgjat kokën,
me zërin melodioz ma bën taaa...
Unë dua s'dua në mes të punën
dhe e marr në krah.

Si lulja në saksi

Nëna! — më thotë djali sa herë.
Nëna, tjetër fjalë s'di.
E ka fjalën për edukatoren,
për nënë Gjyslimen zemërflori.

Në fjalorin e tij fillestar
ka hyrë kjo fjalë si një dashuri,
mbirë në zemrën e vogël,
si lulja në saksi.

Kënga partizane

Na çanë gjoksin predhat,
rrodhi gjaku lumë,
këngën s'na e gjakosën,
s'na e gjakosën kurrë.

Përherë atë e patëm
në buzën tonë të prushtë
mbi armikun hedhur,
barut edhe plumb.

Na çau bajoneta
buzën tej e tej,
po nuk humbi kënga,
kënga nuk u shter.

Lindur thellë në shekuj,
rritur lart në male,
kënga jonë flamur,
kënga partizane.

Sokoli i këngës

Ç'ke marrë një këngë
për trimin e rënë,
isua të dridhet,
siç e dredh zënë.

Ç'ke marrë një këngë,
për trimin e rënë,
moj vajza labe,
përlote një nënë.

U këput e ra si lis,
thua ti me këngë,
moj vajza labe,
ç'e shtange një nënë.

Liria e bëri,
djalin o dëshmor,
tha vajza me këngë
kur kënga mbaroi.

Filloi prap' kënga,
ia mori nëna,
Sokoli i nënës...
Sokoli i këngës...

Ma bënë vendin në zemër

Te ky qytet unë jam e ardhur,
i kam të paktë shokët, më të paktë miqtë.
Larg e kam dhe nënën time,
nënën time të mirë.

Megjithatë këtu e ndiej veten
krejt si bij të tij,
ma bënë vendin në zemër
të gjithë njerëzit e mirë.

Djemtë e nënave

Ç'u bënë djemtë e nënave, ç'u bënë —
thotë kënga.
Nën hijen e qershisë në maj,
kënga.

Ç'u bënë djemtë e nënave, ç'u bënë —
thotë nëna.
Në dritaren e shtëpisë dalë,
nëna.

Ç'u bënë djemtë e nënave, ç'u bënë —
thotë zemra.
Zemra mbushur plot mall,
zemra.

Ku kalojmë duke nderuar,
ku janë lulet në çdo stinë
ku është toka më e kuqe,
djemtë e nënave seç rrinë.

Brenda detit

Gumëzhin e gumëzhin deti si në festë,
festiv është më tepër se sa në qetësi.
Edhe kur sipërfaqen ndeh tej e tej të kaltër,
brenda tij një botë e tërë zgjuar rri.

Indiferenca e një babai

Një fëmijë pyeti babanë një mbrëmje:
Babi, qielli aq i kaltër
tani si u mbush me drita?
Kush i ndezi?
Si erdhi nata?
Po dita?
Si...?

Babai dëgjonte dhe indiferent
shfletonte gazetën që erdhi sot,
ndërsa fëmijës iu mbushën sytë
me lot.

Ka dhe të tillë

Ç'mollë e bukur faqekuqe!
Ç'shije do të ketë brumi i saj,
mendova në çast teksa nga dega
e këputa e në dorë mora ta mbaj.

Molla e bukur faqepaparunë
vështrimin ma rrëmbeu me pamjen e saj,
dysh kur e bëra në duart e mia
i qetë nëpër të ecte krimbi i bardhë.

I mbylla gjysmëmollët e heshtur,
heshtja rrëshqiti sipërfaqes së bukur.
Ç'duhet vallë kjo bukuri e pamjes,
kur në zemrën e saj krimbi ka udhën!

Të jem vazhdimi yt i mirë

Unë me ty krenohem, babai im,
luftëtar ishe që i vogël fare.
Pushka të takonte në çdo hap me tokën,
si dy miq që çmallen të lidhur në halle.

Unë me ty krenohem, babai im.
Krenaria më ndez gjakun në deje
të jem vazhdimi yt i mirë,
luftëtare e pandalur e kësaj epopeje.

Mikpritje

Në portën tonë
në shtëpinë tonë,
për të trokitur
skalitur një dorë.

Miku po të trokasë,
hapet porta,
dhe zemra
plot gaz.

Të gjithë radhitur në front

Mbas mësimit rendëm në fushë,
mbushur fusha me rendje të gëzuara.
Fëmijët aty krah prindërve dërsijnë
madhështore sot fusha, madhështore puna.

Është kohë fushate për misrin,
është fushatë e bukës.
Të gjithë radhitur në front,
si në llogoren e luftës.

Pragjet tona

Pragjet tona,
të bardha
erë gëlqere.

Pragjet tona
mbushur plot
me trëndafilat
e nëntorëve.

Dhe janë
gjithmonë të bardhë,
gjithmonë të kuq,

si ëndrrat,
si flamujt.

Pjesë e qëndresës së tij

Rrëzë Tomorit
këta fshatra kanë qëndruar
ashtu njëri pas tjetrit
si në valle,
duke formuar rrëzë malit
një hark të bukur valleje,
një hark të rrallë.

Dhe qëndruan në luftëra,
si në rrebesh Tomori.
Këta fshatra,
pjesë e qëndresës së tij.

Luletë shkëmbinj

Në tokën ilire kanë hedhur rrënjë
shkëmbinj të ashpër, shkëmbinj të fortë,
qëndruan ata që të gjithë,
që nga lindja deri sot.

Sa e hershme moshë e tyre,
sa të lashtë ata janë,
si në duart e shqiptarëve
«Dyfeku lidhur me gjalm».

Shkëmbinjtë tanë brinjëshpuar,
shkëmbinjtë tanë kockëdalë,
bashkë me ne në luftë qëndruan
porsi shokë të pandarë.

Hynë ata në këngë, vargje,
dhe të lashtë, dhe të rinj,
kjo tokë mbushur plot me lule,
lule shumë dhe shkëmbinj.

Dhe sytë i qeshin

Jam nga Zhepa ime, përgjigjet e gëzuar,
sa herë ndodh ta pyesin nga je.
Dhe sytë i qeshin, ata sytë e shkruar,
si qielli i pastër, si qielli pa rë.

Mbesa ime, e bukur syshkruar
dashurinë e fshatit cicërin ngado,
me zërin e ëmbël si këngë e bilbilit,
si era e freskët në muajt e prillit.

Eh, ti që fshatin e përbuz,
që trishtim të sjell edhe emri i tij,
bashkë le të ndeshemi, ti dhe unë,
veç vogëlushes përpara mos m'i dil.

Lule të çelura

Kur çelte lulet lofata,
mbi krahët shtrirë nga çdo anë,
ne mblidheshim rreth trungut,
rreth trungut të saj.

Mbushur duart me lule lofate,
duart tona lule plot.
Ne u rritëm në çdo çelje,
si lofata mot për mot.

Kushedi sa kohë kam
nga tufë e saj lule pa prerë,
seç na iku fëmijnia
si një lule mëpër erë...

Me sa mall këtu sot erdha,
te ky trung i drejtë, i murmë,
lule shumë prej tij, u çelën,
lule çelur, o pafund.

Pavdekësia lulëzon

Varet dëbora nga çatitë,
pikza kristali kullon pranvera,
hapësirës nderin krahët zogjtë dhe fëmijët,
peizazhi natyror merr ngjyra të ndezura.

Bardhësia e dëborës shkriu ngado,
iku u tret e tëra,
vetëm lapidarëve mbetet ajo,
pret e përcjell pranvera.

Ë tret dëbora,
yjet në gjirin e agimit,
si trandafilë të bardhë çelën lapidarët,
pavdekësia lulëzon me yll të kuq mes blerimit...

Ata ktheheshin në këngë

— baladë —

Vraponin nëpër muzg
ca krisma, ca të shtëna.
Një letër për në çetë,
me ngushëllimet brenda.

Kush e nisi vallë,
këtë natë me luftë?
Ç'zemër digjej zjarr,
ç'zemër ish bërë prush?

Kush kish rënë në mal
e kish hyrë në këngë?
Pranverat në shteg
çelur i kish lënë...

Çelur si një lule,
si një manushaqe,
mbjellur, moj, nga lufta,
nga lufta e madhe.

Kishte rënë Sadushi,
kishte shkruar nëna.
Dritë të bardhë derdhte
përmbi yje hëna.

Heshtja ra në çetë,
në pyllin me lisa.
Ishte vjeshtë e tretë...
Ishte kohë me krisma...

Vraponin nëpër muzg,
vraponin ca të shtëna
dhe letrën që e nisi
me dorë të saj nëna.

«Më të fortë bëhuni,
djemtë tanë trima!»
Pylli sëç u mbush
plot me trëndelina.

Më të fortë bëhuni;
më të fortë djema.
Ç'ngushëllim epik
dalë thellë nga zemra.

Ç'mund të shkruash më,
mendonte komisari,
mbështetur pas një trungu,
në zemrën e një mali.

Nënat rritnin djemtë
e i nisnin në luftë.
Ata ktheheshin në këngë.
me një yll të kuq.

Ktheheshin në këngë,
në lapidar të bardhë.
Ata — themelet
e çelikut shqiptar.

Ata — këngët
si burbuqe mbirë në buzë.
Ata që krah nesh ecin
në çdo shteg, në çdo udhë.

I transferuari

Pak para largimit të tij
nga ky vend, nga këta njerëz,

ai na tha ca fjalë
që rridhnin prej zemrës.

Të thjeshta, të ngadalta
dhe thellësisht të ngrohta.

Si hapat e parë që hedh
pranvera e i ndien toka.

...S'do ta harroj këtë vend,
dhe ju banorët e tij.

Na tha i transferuari
në dorështrëngim.

Autobusi gjëmoi mëngjesit pa mjegull,
iku miku ynë në një detyrë tjetër.

Dje të panjohur, sot shumë miq
e çuditshme koha jonë e mbushur me dritë.

I lidh zemrat i lidh miqësitë
si çeliku i pastër që saldojmë çdo ditë.

Metri i ndërgjegjes sate

Një centimetër sot, një centimetër nesër...
Ha metri i ndërgjegjes sate
duke vjedhur pikat e djersës
nga teritalet e ndryshme, nga basmat plot lule.

Mjaft! — thotë vështrimi që vret.
Mjaft! — thotë heshtja qortuese.
Në goftë se ti do të vazhdosh kështu...
ne do të fillojmë ndryshe...

Mes njerëzve

Kërkund s'e kam vënë emrin tënd
në asnjë poezi.

Megjithatë të njohurit kur ta lexojnë
do të thonë:

— E ka shkruar për atë,
me siguri.

Sepse ne u dashuruam mes njerëzve
e mes njerëzve mbetëm të dashuruar.

Se dielli lind mes rrezeve
qysh herët në të aguar.

Partia, e mira, e bardha

U kthjem nga mbrëmja sonte,
festuam 8 Marsin.

Festat tona dhimbje do të ishin,
po të mos ishte Partia, e shtrenjta.

Gjithë gëzimet të ngrohta na i fali
Partia jonë, e mira, e bardha,
dhe maset çelen brenda zemrës
siç çelen manushaqet e para.

Aksionistja

Një breg i gjatë i kaltër
dhe një kujtim i bukur.
Stërkalat e detit vijnë lagin
Rivierën e rilindur.

Nën rrezet e diellit
sikur saldohen të tëra
dhe ngjan më e bukur
Riviera.

Një brez i gjatë i kaltër
me tarracat mbi supe
dhe unë pranë tij e heshtur,
dikur aksioniste.

Dikur... dhe era më sjell
mijëra valëzime.
Bregdetas! Është Riviera
edhe imja.

Është edhe e Dilës,
është edhe e Prelës.
Dhe dehem në kujtime
këtu pranë Rivierës!

D a s m a

— poemth —

Ajo ishte hera e parë,
hera e parë në mes të tyre.
Ishte ky,
si fillim i bukur i një stine.

Pas saj do të vinin ditët,
si refrene të gëzuara.
Në shpirt ato i kam të gjitha
të gjalla, të jetuara.

Vija në ditën e dasmës,
në ditën më të paharruar,
ajo do të më mbetej në zemër
nga më të rrallat ditë të jetës.

Më prisnin ata fshatarë të mirë,
mua, nusen e largët,
ishin zgjuar pa gdhirë atë ditë
fshati ishte në dasmë.

Ca këndonin veçuar,
ca dy nga dy,
fëmijët pyesnin nënat,
kur do të vijë nusja, kur do të vijë.

2.

Qyteti im është larg.
Qyteti im është në Jug.
Në çastin e mbërritjes, buzëmbremjen pata afër,
njëra-tjetrës i jepnim bukuri të pafund.

Ajo më përcolli në mes të tyre
buzëmbremja, oh, sa e purpurt!
Rënë mbi tërë këto maja
si kurorë gonxhesh e pafund.

Me gjithë bukurinë e ngjyrave
ra këtyre anëve.

Vinte nusja e bukur
përcjellë prej valëve.

E di si iu shfaqta atyre,
ja, në mes të saj si trëndafil i bardhë,
të gjithë zgjatnin kokat
zgjatnin kokat kureshtarë.

Prisnin ata një nuse të re
dikush në shtëpi, dikush përtej fshatit.
Atë natë ndoshta yjet
ndrisnin aq shumë vetëm prej gazit.

Dhe hëna kish dalë atë natë,
si një dasmore aty përmbi mal.
Fshatit në dasmë ajo i derdhi
gjithë bardhësinë e shpirtit të saj.

Dasmorët ia dhanë këngës,
kënga rrëshqiste mbi bardhësi.
Gratë më pushtuan me ngrohtësinë e nënës
o ç'ishte ky çast, ajo ngrohtësi!

Ç'ishte ky çast në hyrje të fshatit?
Ç'është ky çast, moj motra!
Para tij i zbehtë më dukej
bulevardi i gjerë me taksinë te porta.

3.

Kaluan orë, pastaj të thinjurat,
gratë e më të rejat pastaj,
kërkuan pajën e nuses
në duar ta shihnin me radhë.

Paja? Një drithërimë e lehtë...
Ato prisnin unë shtanga në vend.
Mbeti nëpër dhëmbë kënga...
ca fjalë mbetën pa thënë...

Hiqmu qafe, heshtje nusërore!
Do t'i sqaroj vetë këto gra,
me që unë qenkam e para
pa valixhen me pajëra.

Nëna! Më falni që jua prisha
zakonin tuaj rrënjëthellë në shpirt.

Mua, nëna, më mungon paja,
të këndshmet tuaja, qëndisma.

Mua më mungojnë këto, nëna,
trishtëmin e çastit hiqmani nga sytë!
Unë s'dua t'i vrasin zemrat tuaja
bukuritë e çmuara të nusërisë.

Si përçmoj unë jo, bukuritë e tyre
si copëza pranvere mbirë mbi pëlhurë.
Po koha jonë sot kaq e madhe
kërkon nga ne, moj nëna, më shumë.

4.

Të mirat morën vesh çdo gjë,
nuk pritën jo më tej.
Njëra ia dha ëmbël me zë,
tjetra shtruar ia priti andej.

Një këngë të vjetër dasme,
s'më kujtohen fjalët e saj,

veç mbaj mend se si nëpër të
lotët s'munda t'i mbaj.

Lotë dashurie, oh, sa të ëmbël,
më buronin nga shpirti atë çast,
si dy buronja që rrjedhin në ëndërr
mbushur vetëm me zjarr.

Dhe desha të gjitha dasmoret
t'i puthja një nga një me radhë
puthjen tua lija nën gushë,
si një zambak të bardhë.

T'i futja në kraharorin tim
zemërgjerat, të urtat,
shamibukurat mbi krye,
shamibukurat mbi fushat.

Në zor shumë gjatë nuk më lanë,
nuk më lanë jo të mirat.
Edhe sikur në shpirtin e tyre,
Të kishin lënë boshllëk qëndismat.

Sa të mira, belbëzoja me vete
me vështrim ngatërruar nëpër valë,
nuk i mendoja kurrë të tilla
kaq të dashura, zemërbardhë.

Dhe paska njerëz kaq të mirë
në tërë këtë ashpërsi,
çuditërisht gjithë shkrepat m'u bënë
si brigje mbuluar me kaltërsi.

Dhe paska njerëz kaq të mirë,
te ky fshat i largët malor,
brenda mirësisë së tyre unë
jetoj si në atë qytet jugor.

5.

O kjo ishte një dasmë e rrallë
për fshatin malor ballë Tomorit.
Nusja e ardhur kësaj radhe,
vinte nga brigjet e Jonit.

Nuk u shua kënga asaj nate,
asaj nate të bardhë si trëndafil,

i gjithë peizazhi ishte
nusja më e bukur, nusja më e mirë!

Nuk u shua kënga asaj nate
në zemrat e ndezura prej lumturisë.
Në mes tyre ne të dy këndonim,
këndonte bilbili i dashurisë!

6.

Kur shëtisja qytetin tim,
bulevardit që sot më zgjon mall,
përfytyroja bukurinë e fshatit
te cicërimat e gjelbërimi i madh.

Përfytyroja fshatin të bukur,
mbi supet plot yje, me hënën mikeshë,
o, kjo qenka shumë pak
përpara bukurisë së vërtetë.

Kjo qenka shumë pak, vëllezër,
shoqet e mia aty në qytet,
sa keq e mendonim ne fshatin,
ejani, ejani, shikojeni vet'!

Të shihni se ç'zemër kanë
ata në kraharor,
se si ta bëjnë pranverë të gjallë
dhjetorin përmbushur me borë.

Të shihni parcelat e gjera
rrëmbyer nga malet me krahë,
grunjërat kur rëndojnë të tëra,
O, këto janë të pathëna.

Pa le kur gra e vajza
me blerimin hedhur mbi supe
bulëzuar nga djersë e stërvitjes,
të tëra janë Zonja Çurre!

Vështrimi i tyre epik,
aq lirik në orë të lira,
si dy rruzuj të artë rënë prej diellit
mu në mes te lëndina.

S'janë shtojzovalle, nuk janë zana,
as heroina dalë nga gojëdhënat,

janë ato që buzë agimit,
fillojnë e qëndisin arat.

S'janë murgeshat e dikurshme
mbyllur nëpër manastirë,
janë ato që mbajnë jetën
përmbi supe ballëdërsirë.

7.

Kur shëtisja në qytetin tim,
bulevardit që sot më zgjon mall,
s'e mendoja se këtu një ditë
do vihesha me jetën ballë për ballë.

Harroja se këtu në këtë fshat
unë isha nusja e parë,
ardhur nga qyteti me bulevarde
këtu te këta fshatarë.

Më ndoqën nga pas shumë kohë
vështrime të çuditura,

për mua ato genë
çaste të trishtuara.

Pashirrmat e gjata m'u bënë
hone për shpirtin tim,
një e lëshonte atë paditur,
një tjetër me qëllim.

Mbi të gjitha ato unë do të ngrihesha
do të ngrihesha, e dija.
Forcë të madhe do më jepte
nëna e nënave, Partia.

Dhe do të turreshin pas meje një ditë
në këta fshatra rritur si zambak.
O sa shumë pëllumbesha,
pëllumbesha gushëbardha!

Nëpër kaltërsinë e dashurisë
do të jetonim të lumtura.
Bashkëfshatarët do të lumturohen për ato
gushëbardhat e ardhura.

Do të shuhen atëher' pasthirrmat.
si një zë i humbur në mesnatë
që koha jonë i la tutje,
që zemrat tona i lanë pas.

Asgjë s'do t'i çudisë më këta fshatarë,
habinë do ta flakin si një gjë të vjetër.
Papritur do t'u kujtohet nusja e parë,
dhe vetja e tyre do t'u kujtohet patjetër...

PASQYRA E LËNDËS

Pranverën derdhmani në gjoks	3
Pranvera e syve	4
Kemi Partinë	5
Si vajzë e dashuruar	6
Mes nesh komisar	8
Agu i mëngjesit e gjeti zgjuar	10
Skrapari i ri	12
E qeshur	13
Mësuesja e dy fshatrave	14
Pëllumbat e gëzimit	16
Letra e ushtarit	18
Rri e mendoj	20
Dhe i fal një mijë buzëqeshje	22
Ky çast	23
Si lulja në saksi	24
Kënga partizane	25
Sokoli i këngës	27
Ma bënë vendin në zemër	29
Djemtë e nënave	30
Brenda detit	32
Indiferenca e një babai	33
Ka dhe të tillë	34

Të jem vazhdimi yt i mirë	35
Mikpritje	36
Të gjithë radhitur në front	37
Pragjet tona	38
Pjesë e qëndresës së tij	39
Lule e shkëmbinj	40
Dhe sytë i qeshin	42
Lule të çelura	43
Pavdekësia lulëzon	45
Ata ktheheshin në këngë	46
I transferuari	50
Metri i ndërgjegjes sate	52
Mes njerëzve	53
Partia, e mira, e bardha	54
Aksionistja	55
Dasma (poemth)	57

Nelo, V.

E qeshur. Poezi. [Red.: I. Thoma]
T., «Naim Frashëri», 1982.

72 f.

(B.m.) dhe

(B.v.) : 891.983-1

N 41

Tirazhi 1000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1982